



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikës dhe Financa, mbajtur më 04.10.2018, duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani dhe Fadil Gashi.**

**Munguan: Blerand Stavileci dhe Egzon Azemi.**

**Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Valbona Osmani - Mehmetaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës dhe Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues.**

**Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, Osman Bllaca propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)". Halim Halimi tha se fjala është për dhënie në shfrytëzim të pronës, është dashur të dërgohet në Komitetin e pronës, për ta shqyrtuar një herë, e pas qëndrimit të Komitetit të pronës të sillet në KPF.**

**Vala Peshku pyeti se a jeni në dijeni se çfarë projekti është dhe çka po kërkojnë.**

**Osman Bllaca dha përgjigje, duke thënë se ata po kërkojnë 600 m<sup>2</sup> me iu dhënë për shfrytëzim, nuk e di natyrën e punës së ARKEP -së .**

**Sami Boroci u shpreh i pajtimit që të përfshihet ky propozimvendim si pikë në rendin e ditës, se nëse e marrim sot materialin, kemi kohë një javë për ta trajtuar se a me votuar ajo jo, pasi që kemi informata të mjaftueshme.**

Agim Gashi tha se nuk është normale me dhënë një pronë në shfrytëzim pa e ditur arsyetimin pse po jepet. Pas çdo kërkesë jepet edhe arsyetimi.

Dren Kukaj tha se ARKEP e ka kërkuar këtë pronë për nevojat e vendosjes së antenës.

Agim Kuleta, kryesues, e hodhi në votim propozimin për futjen në rend dite të pikës "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)".

Kryesuesi konstatoi se më 9 vota për, futet në rend dite pika: "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)".

Njëzëri u miratua ky

#### REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 prill - 30 qershor 2018, (TM2);
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017;
4. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të NPL " Pallati i Rinisë";
5. Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK);
7. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt;
9. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019;
10. Informim mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe NPL "Hortikultura";
11. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP);
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

## **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 prill - 30 qershor 2018, (TM2);**

**Agim Gashi** tha se tani jemi në muajin e 10-të dhe neve po na ka ardhur raporti 6-mujor, tash është dashur të diskutojmë për raportin 9-mujor, kjo është përpjekje e vonuar. Të diskutohet pas tre muajve për raport financiar, ky diskutim nuk prodhon kurrfarë efekti të ndryshimeve pozitive, sepse çdo trajtim i vonuar nuk prodhon efekt pozitiv.

Për raportin 9-mujor, kërkoj që pasqyrat financiare të jenë të sakta, duke i përfshirë edhe bartjen e mjeteve 14 milionë.

**Agim Kuleta**, kryesues, hodhi në votim **Raportin financiar buxhetor për periudhën 1 prill - 30 qershor 2018, (TM2).**

**Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për, 3 kundër, u miratua Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 prill - 30 qershor 2018, (TM2) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e tretë**

**Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.**

**Halim Halimi** tha se sa i përket Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017, si zakonisht, auditori ka gjetur shumë shkelje, shumë lëshime dhe rekomandimet e vitit paraprak 2016, kanë qenë diku 36, e të cilat nuk janë realizuar, nuk janë përmbushur, ndërsa gjatë këtij viti janë 26 të gjetura, që janë shkelje në veti. Është realizuar vetëm 57% e buxhetit për investimet kapitale, të hyrat shpenzimet e llogaritë e arkëtuara pa një kontrollim të brendshëm. Ne e kemi Njësinë e auditimit të brendshëm, ku është dashur të bëhet kontroll se si po shkojnë punët financiare në Komunë. Ne kemi vërejtje sa i përket auditimit të brendshëm. Po ashtu, janë 30 projekte që nuk janë realizuar fare e që janë paraparë.

Ne kemi shumë vërejtje lidhur me raportin, të cilat më gjerësisht do t'i paraqesim në Kuvend.

**Osman Bllaca** dha sqarime lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.

**Agim Gashi** tha se kur ke të bësh me ndryshimin e kodeve buxhetore, nuk është mirë që ekzekutivi t'i ndryshojë pa vendim të Kuvendit, sepse Kuvendi i Komunës është organ vendimmarrës për çështje buxhetore.

**Osman Bllaca** tha është kategoria buxhetore, ndryshimi në Kuvend, e kemi sjellur për investim kapitale të të hyrave vetanake, e kemi votuar në Kuvend për t'u bërë ndryshime për mallra dhe shërbime dhe për shumë projekte të tjera. Ka kaluar në Kuvend, pastaj e kemi dërguar në Qeveri, por Qeveria nuk e ka bërë rishikimin e buxhetit të tërësishëm dhe në vitin 2017, Ministria e Financave nuk ka bërë fare rishikimi lidhur me Raportin e auditorit.

**Halim Halimi** theksoi se se puna e Komitetit për Politikë e Financa dhe e ekzekutivit, është se si të veprojmë që vitin e ardhshëm të mos na përsëritet mos puna e Njesisë së auditimit, që në të ardhmen mos të jenë të njëjtat vërejtje.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të NPL "Pallati i Rinisë".**

Fatos Dibra dha sqarime, duke cekur se dy aksionarë i ka Kuvendi, që duhet të votohen, ndërsa i treti emërohet nga Kryetari.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të NPL "Pallati i Rinisë" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e pestë**

**Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës.**

**Halim Halimi** bëri të ditur se vërejtja e tij ka qenë edhe në fillim të titullimi i vendimit. Thuhet "Kuvendi i Komunës së Prishtinës është themelues i Muzeut të qytetit të Prishtinës", andaj është mirë që Muzeu të jetë i Prishtinës, e Statuti të jetë Statuti i Muzeut të Prishtinës, kështu që fjala "qytetit" propozoj që të hiqet, pasi që në Statut nuk e kemi fjalën qytet.

Neni 4, te selia, vula dhe logoja, e kemi: "Muzeu i Prishtinës e ka selinë në Prishtinë, në ndërtesën e përcaktuar sipas votimit në Kuvend", frazën "sipas votimit në Kuvend" nuk e kisha lënë kështu, të jetë vetëm "Muzeu i Prishtinës e ka selinë në Prishtinë, rruga UÇK, nr. 10. Neni 4, pika 5, thuhet: "Degët e MP-së mund të kenë logo të veçanta, të ndryshme nga logoja kryesore e institucionit, kurse për përdorimin e përbashkët përpilohen udhëzues shtesë". Nuk e di sa ligjore është DK-ja me i deleguar kompetenca menaxhimit të përkohshëm, disa organizatave që nuk janë pjesë e muzeut, mendoj se nuk është e drejtë.

Neni 10, pika 4, thuhet se Këshillin drejtues të MP-së e emëron dhe e shkarkon DK-ja. Unë mendoj se duhet të thuhet: "Këshillin drejtues të MP-së e emëron dhe e shkarkon Kryetari, me propozim të DK-së".

Neni 10, pika 8, thuhet: "Këshilli Drejtues vendos për dhënien në menaxhim të pjesëve të Muzeut të Prishtinës dhe degëve të tij, organizatave të Shoqërisë civile". Mendoj se kjo nuk është e qëndrueshme.

Neni 21, Shtojcat e Statutit, thuhet se shtojcat që i bashkëngjiten këtij statuti janë pjesë përbërëse e tij: Shtojca I: Përmbajtja e vulës së MP-së dhe Shtojca II: Përmbajtja e logos së MP-së. Këto shtojca nuk i kemi, meqë janë cekur, është mirë që të sigurohen për Kuvend.

**Vala Peshku** theksoi se te nene 10, pika 8, thuhet: "Këshilli Drejtues vendos për dhënien në menaxhim të pjesëve të Muzeut të Prishtinës dhe degëve të tij, organizatave të Shoqërisë civile". Po parashtroj pyetjen se kush i jap në menaxhim pjesët e Muzeut, DK-ja apo Këshilli drejtues. Po ashtu tha ndoshta është gabim fjala menaxhim, ndoshta keni dashur të thoni shfrytëzim.

**Yll Rugova** tha se nëse themi shfrytëzim, është tjetër ligj.

**Agim Gashi** theksoi se këtu thuhet: "Degët e Muzeut të Prishtinës të pavarura", mund të jenë të pavarura, por në dokumentet juridike nuk duhet të përdoret fjala "munden", sepse mund të keqpërdoret.

Muzeu i Prishtinës e ka një këshill drejtues, në qoftë se një degë është e pavarur, e ka vulën, logon e vet, por si është e mundur që disa degë tash t'i referohen një këshilli!

**Yll Rugova** dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit. Sa i përket te Vendimi, ky është gabim në formulim, duhet me thënë: "Muzeu i Prishtinës".

Muzeu i Prishtinës është Muze i Prishtinës, këtë koment po e marr si real. Sa i përket logos, d.m.th. degët e Muzeut mund të kenë logo të veçanta, ne e kemi një institucion bazë, i cili e legalizon çështjen e pastaj po dëshirojmë me ia lënë lirinë secilit veç e veç, prandaj ne e kemi lejuar që të jetë, në njëfarë mënyrë, në kompetenca të tyre se a dëshirojnë të kenë logo tjetër, duke u konsultuar me këshillin drejtues, i cili themelohet nga Komuna e Prishtinës.

Po ashtu, u cek se Këshilli drejtues duhet të themelohet nga Kryetari, edhe për këtë pajtohem si komente. Nëse DKRS propozon emrat, Kryetari duhet t'i miratojë ato.

**Osman Bllaca** pyeti se a është bërë përmirësimi, sepse nuk duhet të jetë DKRS, por DK.

**Ardian Olluri** tha se rendin e ditës së mbledhjes së Kuvendit e cakton Kryetari, bashkë me kryesuesin. KPF-ja nuk mundet me ndryshuar rendin e ditës, ajo çka bën Komiteti, ajo diskuton për atë pika dhe mundet me dhënë rekomandime, dhe çka ishte dashur me u votuar. Është dashtë me u votuar për rekomandime, si p.sh. Halim Halimi pat rekomandime konkrete, ato rekomandime është dashtë me u votuar a me i shkuar Kuvendit si rekomandime prej Komitetit dhe Kuvendi me ditur çka ka rekomanduar Komiteti, e pastaj në Kuvend me u miratuar ose jo ato ndryshime.

**Agim Kuleta**, kryesues, u shpreh i pajtimit me Ardianin.

**Halim Halimi** tha se është mirë me i diskutuar vërejtjet e dhëna se a janë të arsyeshme, nëse janë të arsyeshme, atëherë për Kuvend teksti me shkuar i spastruar dhe ne në Kuvend nuk i përsëritim vërejtjet.

**Vala Peshku** theksoi se kur të dërgohet materiali në Kuvend, duhet me qenë me rekomandimet e përfshira.

**Eman Rrahmani** shprehu mendimin se duhet votuar këto rekomandimet që po jepen nga anëtarët e Komitetit dhe kur të prezantohet në Kuvend, me u prezantuar se kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur me miratim të KPF-së.

**Agim Gashi** tha se janë disa pika të rendit të ditës që nuk mund të hyjnë në Kuvend pa kaluar nëpër Komitet, p.sh te propozimet për këmbimin e pronës për shfrytëzim, nuk duhet të dërgohet në Kuvend pa kaluar nëpër Komitet. Komiteti është një lloj korrektori, gabimet teknike, gabimet që i vëren Komiteti ka, të drejtën e përmirësimit dhe shkon teksti pak më i saktë.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se këto që po i përmend zotëri Gashi, munden me shkuar pa kaluar nëpër KPF, dhënia në shfrytëzim e pronës, këmbimi, janë propozime të Kryetarit. Rregullorja e Komitetit përcakton se çka shqyrton, është një praktikë e gabuar që në Komitet vijnë krejt dhe diskutohet gjithçka, por në Rregullore është që Komiteti është përgjegjës për shqyrtimin e politikave fiskale, kornizën vjetore, rregulloret vjetore, buxhetin vjetore dhe tatimet në pronë.

**Agim Kuleta**, kryesues, theksoi se këtu jepen rekomandime, jepen ide, votohet rekomandimi, është shumicë, bëhet rekomandim i Komitetit dhe i shkon Kuvendit.

Tash me rekomandime, a po shkojmë me sistemin që Komiteti me shkuar në Kuvend me rekomandime, apo përfshihen në tekste?

**Yll Rugova** premtoi se në tekste gjithsesi do t'i përfshijë rekomandimet.

**Agim Kuleta, kryesues,** tha se tani e tutje gjithë ne që kemi propozime për ndryshimin për të ndryshuar diçka në dokumente, me sjellë në formë amandamenti të shkruar, ne e diskutojmë a ka nevojë për ta ndryshuar apo plotësuar, si amandament e votojmë, nëse shkon me vota shumicë, atëherë e dërgojmë në Kuvend.

**Vala Peshku** tha se nuk do të thotë gjithmonë me ardhur propozimet e shkruara, sepse ne mundemi me keqkuptuar diçka, mirëpo me shpjegimet që i marrim këtu anulohet teoria se është diçka gabim.

**Yll Rugova,** u shpreh se, me sa po e kuptoj, kur të sillet në Kuvend duhet t'i ketë këto rekomandime, në mënyrë që të jem korrekt ndaj këtij takimi.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës, me rekomandimet e zotëri Halimit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).**

**Dren Kukaj** i njofto të pranishmit për propozimin e BQK-së për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të cilën e kishte në shfrytëzim Drejtoria e Investimeve Kapitale.

**Ardian Olluri** dha sqarime sa i përket interesit, por është kompetencë e Kuvendit që të vendosë me dhënë me kompensim apo pa kompensim. Propozimi i ekzekutivit është me dhënë pa kompensim, por Kuvendi është ai që vendos për këtë.

**Fadil Gashi** pyeti se a e parasheh ligj që kjo pronë të jepet me interes. Nëse e parasheh ligji, atëherë të jepet me interes.

**Genc Bashota** theksoi se e parasheh ligji, por ne kemi vendosur pa interes, sepse është institucion publik.

**Agim Gashi** e përkrahu dhënien e kësaj prone në shfrytëzim, por dhënia për 99 vjet nënkupton falje, pse Komuna mos me lidhë një marrëveshje që së paku një shkollë me u ndërtuar apo çerdhe, si kompensim simbolik, ose me iu dhënë, nëse ka mundësi, për një periudhë 30-vjeçare, si të arrihet marrëveshje dy palëshe.

**Vala Peshku** tha se duhet vendosur se a dëshirojmë me i kërkuar dikujt kompensim apo jo, e nuk mundemi ne kohë pas kohe, sipas dëshirës, BQK ka para dhe duhet kërkuar kompensim, ose vendosim të kërkojmë kompensim për të gjithë dhe i bëjmë disa kritere prej kujt çka kemi me kërkuar.

**Sami Boroci** theksoi se pavarësisht modalitetit se a kemi me marrë kompensim a jo, është mirë me gjetur një formë kompensimi sado qoftë modeste.

**Jonuz Salihaj** bëri të ditur se Drejtoria e Arsimit qëndron keq me hapësirë të punës, në një sallë janë 15-16 punëtorë, e në anën tjetër tash po ia japim një objekt BQK-së, një objekt që kemi menduar me e shfrytëzuar ne si Drejtori e Arsimit. Kuvendi kur të marrë vendim për këtë, besoj se do ta ketë parasysh këtë çështje.

**Halim Halimi** tha se ne jemi zgjedhur nga qytetarët e komunës së Prishtinës për të mbrojtur interesat e Komunës së Prishtinës. Unë nuk kam besuar se në një sallë punojnë 15-16 punëtorë, derisa i kam pa vetë se në çfarë gjendje ishin, e ne po falim prona. Ka nevojë BKQ-ja, por ne së pari t'i kemi parasysh interesat e Komunës, jo 99 vjet, që nënkupton falje, por të jepet për 20-30 vjet ose me një lloj kompensimi.

**Fatos Dibra** bëri të ditur se afati për dhënie në shfrytëzim mund të ndryshojë, Ligji e parasheh nga 15-99 vjet. Propozimi i ekzekutimit është me dhënë për 99 vjet, mundet Kuvendi me votuar mos me dhënë për 99 vjet, por me dhënë 15-30 vjet.

**Eman Rrahmani** u shpreh se përveç DA-së, në gjendje edhe më të keqe janë drejtoritë e tjera. **Genc Sherifi** tha se nëse pajtoheni mos me votuar për BQK-në dhe nëse merret vesh Komuna që me ia dhënë DA-së, ne jemi për, le ta shfrytëzojë, vetëm ju të jeni dakord në Këshillin e drejtorëve.

**Genc Bashota** tha se ne e kemi obligim me u marrë me politika lokale dhe nevojat të cilat mund të përmirësohen, në këtë rast gjendjen e këtyre kategorive ndoshta është nevojë urgjente t'ua zgjidhim.

**Dren Kukaj** tha se objekti i Komunës së re ka probleme, është objekt problematik, ndërsa sa i përket BQK-së, ne kemi menduar me ia dhënë objektin në shfrytëzim BQK-së por ju vendosni.

**Agim Gashi** tha se është mirë të votohet për, mirëpo deri në mbledhje të Kuvendit, ekzekutivi duhet negociuar me BQK-në për modalitetin, ose kërkesë për një periudhë 30-vjeçare, pa kushte ose për më gjatë, mirëpo BQK duhet marrë barrë financiare për Komunën, në emër të kompensimit me bërë ndërtimin e ndonjë objekti.

**Genc Bashota** tha se nuk e shohë të arsyeshme me biseduar ekzekutivi për modalitetin me BQK-në brenda kësaj jave.

**Fadil Gashi** u shpreh se ne kemi gabuar, andaj po dëshirojmë t'i përmirësojmë gabimet, dhe duhet të parashihet kompensim nga BQK-ja për shfrytëzimin e objektit.

**Eman Rrahmani** e përkrahu dhënien e kësaj prone për 99 vjet, por tha se duhet të bëhet vlerësimi sa është qiraja për atë pronë dhe në bazë të saj me dhënë në shfrytëzim për sa vjet e kërkojnë.

**Vala Peshku** kërkoi që të merret një vendim, që do të ishte i njëjtë për të gjithë dhe i përcakton kriteret në Kuvend.

**Ardian Olluri** bëri të ditur se dhënia në shfrytëzim është e përcaktuar me ligj të veçantë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e shtatë**

Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

**Genc Bashota** dha sqarime lidhur me Propozimvendimin për fillimin e revidimit të planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

**Ardian Olluri** tha me këtë vendim, sipas planit pjesa më e madhe ka qenë publike, e një pjesë është paraparë ndërtim, pra me këtë vendim është pamundësua realizimi i tërësishëm i atij

plani, nuk mund të ndërtohet në atë zonë të planifikuar. Për t'u zhbllokuar situata, duhet ndryshua plani.

**Genc Bashota** tha se duhet bërë me revidim të hapësirës e cila është jashtë zonës.

**Ardian Olluri** tha se ajo çka ka propozuar Kuvendit, është që të autorizohet drejtori i Planifikimit për fillimin e punës për përgatitjen e planit të revidimit.

**Agim Gashi** shprehu dyshim se do të realizohet, sepse Qeveria nuk ka mjete për t'i shpronësuar këto prona private. Do të kemi probleme me ligjin për fillim të revidimit të planit, pasi që nuk e kemi miratuar Hartën zonale.

**Genc Bashota** dha sqarime lidhur me këto çështje, duke cekur se vitin e kaluar e kemi bërë këtë plan dhe e kemi miratuar në Kuvend. Tani jemi duke pritur prej Ministrisë një konfirmim, që na kanë thënë se mund të bëjmë Plan të hollësishëm rregullues.

**Sami Boroci** tha se do të ishte mirë që ta kemi ne si dokument Planin rregullues të miratuar të vitit të kaluar.

**Halim Halimi** pati pyetje për Zyrën ligjore lidhur me Ligjin për planifikim hapësinor, se si bëhen planet e hollësishme rregulluese dhe revidimi i Planit të hollësishëm. Me sa e di unë, sipas ligjit parashihet që së pari të nxirret Harta zonale, pastaj Plani rregullues. Ne e dimë se shume plane të hollësishme rregulluese na janë kthyer nga Ministria si të paligjshme.

**Ardian Olluri** dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga zotëri Halimi.

**Eman Rrahmani** shprehu shqetësime lidhur me mosdërgimin edhe të pjesëve të tjera të qytetit që nuk kanë Plan rregullues, si p.sh. "Kodra e Trimave", ku gjysma e lagjes nuk kanë të drejtë të ndërtojnë, sepse nuk ka Plan rregullues.

**Genc Bashota** tha se nuk jemi duke bërë plan të ri rregullues, por një plan ekzistues rregullues.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e tetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt.

**Dren Kukaj** dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

**Fatos Dibra** bëri të ditur se ka qenë edhe më parë në Kuvend, por në Kuvend është tërhequr, sepse problemi ka qenë që pronarët e kanë pasur tokën në hipotekë. Tani çdo gjë është në rregull sa i përket dokumentacionit për t'u realizuar. Prona që iu merret pronarëve është për ndërtim të rrugës.

**Agim Gashi** pyeti se a është vërtetuar heqja e hipotekës nga ana e Komunës.

**Fatos Dibra** sqaroi se kjo është vërtetuar me certifikatë të pronës.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e nëntë**

**Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019.**

**Jonuz Salihaj** njoftoi se përveç Informatës për fillimin e vitit shkollorë 2018-2019, tani për Kuvend do të jetë edhe Raportin për suksesin dhe rezultatet e arritura të nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit 2017/2018.

**Agim Gashi** theksoi se te informata mungojnë disa të dhëna statistikore sa i përket arsimit, të përfshihen pasqyrat lidhur me institucionet dhe numrin e nxënësve nëpër institucione, në informatë të përfshihen pengesat e juaja që nuk keni mundur t'i realizoni synimet. Gjithashtu, në informatë të përfshihen edhe statistikatat e institucioneve private.

**Jonuz Salihaj** u shpreh se sa u përket institucioneve private, nuk kam ndikim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019, me propozimet e zotëri Agim Gashit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e dhjetë**

**Informim mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe NPL "Hortikultura".**

**Osman Bllaca** tha se nga aksionarët dy janë nga Kuvendi dhe një nga Kryetari.

**Halim Halimi** lidhur me raportin e Ndërmarrjes Publike Banesore dhe NPL "Hortikultura", theksoi se nuk tregon se është raporti i aksionarëve, por raporti i menaxhmentit. Sipas ligjit parashihet që aksionarët në Kuvend të raportojnë për gjendjen ekonomiko-financiare në ndërmarrje.

**Agim Kuleta, kryesues,** tha se raportet kanë ardhur dhe besoj se drejtorët do të raportojnë në Kuvend me një ekspozë lidhur me raportet.

**Dren Kukaj** tha se dokumentet që i kemi bashkangjitur tregojnë se si është gjendjen financiare dhe si ka qenë vitin e kaluar, dhe çka po dëshirojmë të bëjmë tash e tutje.

**Sami Boroci** tha se neve na intereson se cilat janë objektivat e së ardhmes të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe NPL "Hortikultura", cilat janë planifikimet dhe procesi i konstituimit të bordeve, shëfave.

**Agim Gashi** tha se Ligji e cakton se çka duhet të raportojnë aksionarët. Janë dy-tri kompetenca që i kanë aksionarët, si çështja financiare në ndërmarrje, prona, vlerësimi i pronës, rritja e pronës, menaxhimi i mirë etj.

**Eman Rrahmani** kërkoi të bëhet një auditim i performancës, auditim i jashtëm dhe një auditim financiar, për të parë ku kanë qenë gabimet, dështimet etj.

**Vala Peshku** tha se kemi biseduar në Kuvendin komunal për trajtimin e ndërmarrjeve publike, kemi thënë po kërkojmë raport prej aksionarëve që janë jashtë dispozitave ligjore, që ata veç i kanë dërguar njëherë, nënkuptohet veç raportet financiare, mirëpo nuk i kemi të gjitha raportet që duhet të hyjnë si planet, objektivat si i kanë paraparë, si dëshirojmë me bërë raportin e punës dhe ku e shohin ndërmarrjen ky bord i aksionarëve pas 4 vjetëve.

**Genc Sherifi** theksoi se neve na takon me zgjedhur një bord të mirë, bordi i dinë disa gjëra, e tani jemi në proces të përzgjedhjes së bordit, konkursi është kryer, bordi zgjidhet së bashku me Ambasadën angleze, si monitoruese. Ne nuk mund të ndërhyjmë në NP, por edhe nuk jemi profesionist të fushës.

Ismail Kokaj tha se unë e kamë marrë raportin nga "Hortikultura" dhe është e cekur se në cilin ligj duhet thirrur për NP, por është edhe Ligji nr. 04/L-111, neni 18, menjëherë pas nenit 18 vjen neni 31, pika 31.3, brenda tyre përshkruhen të gjitha.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informimi mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore(NPB) dhe NPL "Hortikultura" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta